



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

BURSA STUDIMI MASTER NË AUSTRI
VITI AKADEMIK 2019-2020

Universiteti i Klagenfurt-it në Austri në bashkëpunim me Agjencinë Austriake për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Arsimin dhe Kërkimin (*Austrian Agency for International Cooperation in Education and Research – OeAD*) ka shpallur thirrjen për aplikime me bursë studimi për studentët e huaj që dëshirojnë të kryejnë studimet Master në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për vitin akademik 2019-2020.

Në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë të Karinth-it (Carinthian Chamber of Commerce WKO), Universiteti i Klagenfurt-it synon të rrisë numrin e profesionistëve të kualifikuar ndërkombëtarë në sektorin e TIK, duke i mbështetur ata financiarisht për të kryer praktika pune (*interships*) gjatë periudhës së studimeve Master duke qenë se përfshihen në kurrikulën e këtij universiteti. Programi i studimeve zhvillohet në gjuhën angleze. Kandidatët duhet të kenë certifikatë të njohjes së gjuhës angleze në nivelin B2 (TOEFL, IELTS, APIEL etj.).

Të gjithë aplikantët e interesuar për këto bursa studimi duhet të bëjnë regjistrimin dhe plotësimin e formularit të aplikimit **online** në adresën:

<https://grants.at/en/>; <https://www.scholarships.at/default.aspx>;

Afati i fundit për aplikim është **data 12.05.2019**

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, ju lutemi referojuni informacionit bashkëlidhur dhe adresave në web-site:

<https://www.aau.at/studium/studierendenleben/stipendien-und-zuschuesse/technology-scholarships/>;

e-mail: katharina.engel@oead.at; technology.grants@aau.at;

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS